



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 8216/2 Prot.,

Tiranë më 17 / 9 2019

URDHËR

NR. 457, DATË 17.9.2019

PËR
MIRATIMIN E STATUTIT TË FEDERATËS SHQIPTARE TË BOKSIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe nenit 16 të ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Federatës Shqiptare të Boksit, propozuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Federatës Shqiptare të Boksit, nr. 2, datë 22.03.2018, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri (26 faqe).
2. Federata Shqiptare e Boksit, të ndjekë procedurat e regjistrimit të statutit pranë gjykatës kompetente në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
3. Statuti ekzistues i Federatës Shqiptare të Boksit, i miratuar në bazë të Ligjit nr. 9376, datë 21.04.2005 “Për Sportin”, i shfuqizuar, shfuqizohet.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë dhe Federata Shqiptare e Boksit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

Kostandin SHKURTI

